



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:101453
Datë: 20.05.2024
Numri i dokumentit: 05706525

A.C.nr.10371/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryetar, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtar, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Komuna Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Orgeta Qerimi, kundër të paditurit L.Sh., nga fshati Sh..., Komuna Lipjan, të cilin e përfaqëson me autorizim B.H., avokat me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.782/2020 datë 06.09.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit L.Sh., nga fshati Sh..., Komuna Lipjan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.782/2020 datë 06.09.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.782/2020 datë 06.09.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit me seli ne Prishtine, si e BAZUAR dhe OBLIGOHET i padituri L.Sh. nga fshati Sh..., qe paditëses t'ia paguaj shumen prej 2.494.00-€, ne emër te rimbursimit te demit te

shkaktuar ne aksidentin e komunikacionit rrugor te dt. 12.07.2011, ne rrugën e fshatit R... te Lipjanit, te paguara te dëmtuarit B.M. nga Lipjani dhe A.K., me kamate sipas shkalles se kamatës qe paguajnë bankat për mjete te deponuara ne banke ma tepër se nje vite, pa destinim te caktuar, duke filluar nga 09. shtator te 2013, e deri te pagesa definitive, si dhe shumen prej 120,00.-€, ne emër te shpenzimeve te procedurës kontestimore, te gjitha këto ne afat prej 15 dite nga dita e dorzimit te keti aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarimit te dhuneshem...”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri, për shkak të: konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurit, dhe të anulohet aktgjykimi dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditëses.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe gjeti se:

- Ankesa e të paditurit, është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Komuna Prishtinë, me datë 09.09.2013, përmes të autorizuarit të tij, ka paraqitur padi ndaj të paditurit L.Sh., nga fshati Sh..., Komuna Lipjan, me kërkesë për rimbursim të dëmit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, departamenti i përgjithshëm, ka nxjerrë aktvendim C.nr.3165/2013 datë 04.03.2016, me të cilin ka vendosur që të konsiderohet e tërhequr padia e paditëses BKS.

Kundër aktvendimit C.nr.3165/2013 datë 04.03.2016, ka paraqitur ankesë paditësja BKS, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ka nxjerrë aktvendim Ac.nr.1648/2016 datë 18.01.2018, me të cilin ka vendosur që të pranohet si e bazuar ankesa e paditësit, dhe e ka prishë aktvendimin C.nr.3165/2013 datë 04.03.2016, dhe lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Lipjan, departamenti i përgjithshëm, ka nxjerrë aktgjykim C.nr.36/18 datë 27.08.2018, me të cilin ka vendosur që të aprovohet kërkesëpadia e paditëses BKS.

Kundër aktgjykimit C.nr.36/18 datë 27.08.2018, ka paraqitur ankesë i padituri për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, ka nxjerrë aktvendim Ac.nr.5525/2018 datë 14.07.2020, me të cilin ka vendosur që të aprovohet ankesa e të paditurit dhe çështjen e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë pas kthimit të lëndës dhe pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 06.09.2021, dhe pas dëgjimit të palëve dhe pas administrimit të provave, ka marrë aktgjykim C.nr.782/2020 datë 06.09.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, Byroja Kosovare e Sigurimit, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *“...Gjykata i vlerësoj edhe kundërshtimet e palës së paditur, se është ne pozit të veshtire materjale dhe nuk ka mundesi ta rimbursion demin , si dhe se ne kohën kur ka ndodhe aksidenti i padituri ka qen duke punuar ne autoservisin “S...”, qe mirret me servisimin e veturave, por te njëjtave kundërshtime nuk mundi tua fal besimin, nga se si qe rezulton nga mendimi i ekspertit gjyqsor te komunikacionit rrugor, aksidenti ne komunikacionin rrugor ne te cilit te demtuarit kan pesuar dem materjal dhe jo materjal, është shkaktuar me leshimet ekskluzive te te paditurit si ngases i automjetit, i cili automjet, ne kohën e shkaktimit te aksidentit nuk ka pase sigurim te obligueshem nga autopergjegjesia, dhe mbi kete baze rrjedh edhe pergjegjsia e te paditurit per rimbursim demi. Gjykata poashtu pati parasysh edhe thenjet e pales se paditur se është ne gjendje te veshtire ekonomike dhe nuk ka mundesi ta permbushë obligimin per rimbursimin e demit, por kjo rrethane nuk mund te ndikoj qe te mirret vendim tjetër nga ai qe është marrur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi. Duke vepruar sipas vërejtjeve te dhëna nga gjykata e shkalles se dyte ne aktvendimin AC.nr.5525/2018 i dt. 14.07.2020, Gjykata kërkoi nga i padituri te ofroj prova se ka qene ne mardhenje pune tek autoservisi “S...”, ne kohën kur ka ndodhur aksidenti i komunikacionit rrugor, se automjeti me te cilin ka shkaktuar aksident e ka vozitur me urdhër te punëdhënësit, por lidhur me kete gjate procedurës se zhvilluar, i padituri nuk ka sjell prova materjale...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, sepse në nenin 18.1 të Ligji Nr.04/L-018 Për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia në mënyrë decisive thuhet se : *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësise, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e demit nga Byroja”*, ndërsa në nenin 18.4 në mënyrë decisive thuhet se: *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar,*

shpenzimet dhe kamatat". Në kuptim të këtyre dispozitave konstatohet se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ku nuk ishte kontestuese baza juridike në këtë procedurë kontestimore, pasi që eksperti i komunikacionit S.B., në ekspertizën e komunikacionit datë 24.07.2018 ndër të tjera ka konstatuar se *"...Deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur si pasojë e asaj se (L.Sh.) drejtuesi i automjetit xxx "A" ka kaluar në shiritin (anën) që i takonte për lëvizje automjetit "B"...ngasës "B" nuk ka kontribuar në aksident"*, andaj Gjykata e Apelit vlerëson se gjendja faktike në këtë çështje është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë, dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për të cilat arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor të palës së paditur se kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të drejtës materiale nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të palës së paditur, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartpërmendurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në bazë të nenit 195.1 pika d), e lidhur me nenin 200 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
A.C.nr.10371/2021 datë 20.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi